



SYLLABUS I LËNDËS “2.2 Fonetikë dhe fonologji e gjuhës gjermane”

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	2.2 Fonetikë dhe fonologji e gjuhës gjermane
Programi:	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I, sem. 2
Numri i orëve në javë:	2 +2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Ligjërata: E hënë, Gr. 1. / 09:00 – 10:30; Gr. 2. / 10:30-12, Kl. 116 Ushtrime: Ass. Vezire Krasniqi E premte, Gr. 1. / 14:00 – 15:30; Gr. 2. / 15:30-17, Gr. 3. Kl. 116 17-18:30, Kl. 116
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. asoc. dr. Izer Maksuti, Konsultime E martë: 13:00-14:00, si dhe para dhe pas mësimt
Të dhënat kontaktuese:	izer.maksuti@uni-prizren.com 045/346 341
Përshkrimi i lëndës:	Lënda synon të merret fillimisht me definicionet bazë të fonetikës dhe fonologjisë. Do trajtohen karakteristikat të këtyre fushave për gjermanishten, si dhe veçori të shqiptimit të gjuhës gjermane. Nisur me njohjen dhe emërtimet në dy gjuhë, gjermanisht dhe shqip, të aparatit dhe organeve të të folurit, njohjen me inventarin tingullor të gjermanishtes, veçoritë e realizimit ortografik të zanoreve dhe bashkëtingëlloreve, njësitë mbisegmentore, prozodia, tonet dhe intonacioni, proceset fonologjike, si dhe njohja me shenjat e transkriptimit, janë tema të radhës që do trajtohen gjatë semestrit.
Qëllimi i lëndës:	Qëllimi i lëndës është të bëjë një hyrje në lëndën e fonetikës dhe fonologjisë të gjuhës gjermane. Ndër qëllimet kryesore mbeten: <ul style="list-style-type: none">- Të kuptuarit e koncepteve themelore të fonetikës dhe fonologjisë është një nga synimet kryesore të lëndës.- Të kuptuarit e proceseve të nyjëtimit të tingujve dhe parimeve fonetike dhe fonologjike të gjermanishtes- Mësimi i alfabetit ndërkombëtar fonetik dhe aftësimi i studentëve për shfrytëzimin e tij.- Njohja me parimet e transkriptimit fonetik (IPA)- Rëndësia e fonetikës e fonologjisë në mësimin e gjermanishtes si gjuhë e huaj



Rezultatet e të nxënit:	<p><i>Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studenti do të jetë në gjendje që:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - T'i kuptojë proceset e rregullta fonetike dhe fonologjike dhe proceset e nyjëtimit të tingujve të gjermanishtes - T'i zbatojë konceptet e përvetësuara teorike të fonetikës dhe fonologjisë - T'i përshkruajë tingujt e gjermanishtes sipas kritereve fonetike dhe fonologjike, - Të njeh, lexon e përdor në mënyrë korrekte shkrimin fonetik (IPA) - Të përshkruajë dhe vlerësojë rëndësinë e fonetikës dhe fonologjisë në procesin e mësimit të gjuhës gjermane si gjuhë e huaj. - Të ndërlidhë kompetencën fonologjike për përvetësim të ortoepisë dhe ortografisë 		
Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në terren			
Kollokfiume, seminare	1	15	15
Detyra të shtëpisë	1	3	3
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuis, provim final)	1	2	2
Projektet, prezantimet, etj	1	15	15
Totali			125 orë (5 ECTS)
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime, diskutime, punë në grupe, tema për ushtrime në shtëpi etj.		

	Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike, ushtrimeve në klasë, detyrave të shtëpisë.
Metodologjia e vlerësimit:	<p>Përcjellja e punës së gjithmbarshme të studentëve bëhet në mënyrë të vazhdueshme përmes <u>protokolleve të vëzhgimit</u>, punimeve me shkrim , diskutimeve të mbështetura në burimet relevante dhe me vlerësimet e pjesës së parë dhe të dytë të provimit, gjatë semestrit. Për secilën veprimtari të angazhimit mbimesatar të studentëve fitohen pikë të veçanta. Studentët varësisht nga niveli i angazhimit të tyre në punën e drejtpërdrejt arsimore, të leximit në kohën e tyre të lirë, hartimit të punimeve me shkrim etj. kanë mundësi të grumbullojnë deri në 100 pikë.</p> <p>Vlerësimi në % Pjesëmarrja e rregullt 10 % Angazhimet javore, leximi, ushtrimet, detyrat 10% Pjesa e parë e provimit 30 % Pjesa e dytë e provimit 30 % Provimi me gojë 20 %</p>
Literatura	
Literatura primare:	<p>Buch, Albert/Stenschke, Oliver (2008): Germanistische Linguistik. Eine Einführung. Tübingen: Narr. (Einheit 1-3)</p> <p>Grassegger Hans (2006): Phonetik, Phonologie. Idstein: Schulz-Kirchner Verlag</p> <p>Graefen G/Liedke M. (2008): Germanistische Sprachwissenschaft. Tübingen: A. Franke Verlag (fq. 199 – 213)</p> <p>Staffeldt, Seven (2010): Einführung in die Phonetik, Phonologie und Graphematik des Deutschen: Ein Leitfadens für den akademischen Unterricht. Verlag: Stauffenburg.</p> <p>Phonetik für Deutsch als Fremdsprache / http://www.klett-sprachen.de/download/8817/W640636_KLETT_TippsDaF_web.pdf</p>
Literatura shtesë:	<p>DUDEN 2005. Aussprachewörterbuch. Bd. 6. Mannheim: Duden Verlag</p> <p>Petursson, Magnus/Neppert, Joachim M.H. (2002): Elementarbuch der Phonetik. Hamburk: Buske.</p> <p>Wiese, Richard (2011): Phonetik und Phonologie. Paderborn: Fink</p> <p>Si dhe tekste paralele të fonetikës e fonologjisë, në shqip apo gjuhë të tjera.</p> <p>Arsllani, Hamit (2005): Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe. Shkup: Interdiskont.</p> <p>Dodi, Anastas (2004): <i>Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe</i>.</p>

	<p>Tiranë: ASHSH: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.</p> <p>Jashari, Ali/Kryeziu, Bahtijar (2010): Gjuhë amtare (Njohuri për gjuhën: Fonetikë, morfologji, sintaksë). Prishtinë. (fq. 5-71).</p> <p>Memushaj, R. (2002): Hyrje në gjuhësi. Tiranë: Dituria.</p> <p>Link: Literature shtese per kete lende: http://www.daf.uni-mainz.de/Bibliographien/bibphon.htm</p>
--	---

Plani i dizajnuar i mësimi:		
Java	Ligjërata	Ushtrime
<i>Java e parë:</i>	Hyrje, çështje organizative, plani – Hyrje në fonetikë, nocionet bazë; Fonetika dhe fonologjia; dallimet; Degët e fonetikës	Shpërndarja e syllabuseve dhe sqarime lidhur me literaturën: obligative dhe ndihmëse.
<i>Java e dytë:</i>	Fonetika nyjëtimore; aparati i të folurit dhe pikat nyjëtimor. Organet e të folurit; artikulimi; vendet dhe mënyrat e nyjëtimor	Ushtrime, përforcime, përsëritje e materialit të zhvilluar në ligjërata
<i>Java e tretë:</i>	Inventari tingullor i gjermanishtes; zanoret, bashkëtingëlloret; monoftongjet, diftongjet; veçoritë në gjermanisht	Ushtrime, përforcime, përsëritje e materialit të zhvilluar në ligjërata
<i>Java e katërt:</i>	Realizimi ortografik i zanoreve dhe i bashkëtingëlloreve	Ushtrime, përforcime, përsëritje e materialit të zhvilluar në ligjërata
<i>Java e pestë:</i>	Fonetika akustike dhe auditive	Ushtrime, përforcime, përsëritje e materialit të zhvilluar në ligjërata
<i>Java e gjashtë:</i>	Hyrje në fonologji (Fonetikë funksionale), nocionet bazë: fon, fonem, allofon; analiza fonologjike	Përmbledhje, përsëritje Përgatitje për provim
<i>Java e shtatë:</i>	Pjesa e parë e provimit	
<i>Java e tetë:</i>	Fonologjia e rrokjes (Silbenphonologie). Nocionet bazë, struktura Njësitë mbisegmentore	Ushtrime, përforcime, përsëritje e materialit të zhvilluar në ligjërata

	(Suprasegmentalia); Prozodia, tonet dhe intonacioni	
<i>Java e nëntë:</i>	Proceset fonologjike (Prozessphonologie); bazat, tipet e rregullave fonologjike; ndryshimet fonologjike (fonemore), Merkmalphonologie	Ushtrime, përforcime, përsëritje e materialit të zhvilluar në ligjërata
<i>Java e dhjetë:</i>	IPA; Shenjat e transkriptimit Transkriptimi sipas IPA; Transkriptim tekstesh; problemet e realizimit	Ushtrime, përforcime, përsëritje e materialit të zhvilluar në ligjërata
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Roli i fonetikës për mësimin e gjermanishtes si gjuhë e huaj	Ushtrime, përforcime, përsëritje e materialit të zhvilluar në ligjërata
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Vetëdijesimi fonologjik (Phonologische Bewusstheit)	Ushtrime, përforcime, përsëritje e materialit të zhvilluar në ligjërata
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Fonologji dhe grafematikë; nocionet bazë; Shkrimi, sistemet dhe llojet e tij	Ushtrime, përforcime, përsëritje e materialit të zhvilluar në ligjërata
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Ortoepi dhe ortografi	Përmbledhje, përsëritje Përgatitje për provim
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Pjesa e dytë e provimit	
Politikat akademike dhe kodi i sjelljes		
<p>Në procesin e mësimdhënies sigurohen kushte të favorshme për studentin, duke u zhvilluar në një mjedis të përshtatshëm, me mjete të duhura, si dhe me raporte të mira me kolegët.</p> <p>Kusht i ndjekjes dhe suksesit për këtë lëndë është edhe fakti që të ketë të dhënë lëndën: Hyrje në linguistikën e gjuhës gjermane</p> <p>Kodi i sjelljes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrja aktive e studentëve në mësim: ligjërata e ushtrime, • Përgatitje paraprake për njësitë të cilat zhvillohen; leximi, detyrat etj. • Pjesëmarrje në diskutim, komente dhe shprehje të lirë e opinionit dhe qëndrimin akademik, • Respektimi i orarit të ligjëratave pa e cenuar lirinë akademike (shkyçje e telefonave celular etj). 		